



SHOQATA E SIGURIMEVE TË KOSOVËS
INSURANCE ASSOCIATION OF KOSOVA

MANUALI I TRAJNIMEVE

Prishtinë, Maj 2019

PËRMBAJTJA:

I.	Kapitulli për trajnimet dhe provimin për licencim.....	7
II.	Kapitulli për trajnimet e vazhdueshme	11
III.	Kapitulli për trajnimet profesionale	13
IV.	Kapitulli për trajnimet për biznese.....	17
V.	Kapitulli për trajnimet për Insitucione të edukimit	
VI.	si shkolla, universitete, kolegje dhe si shoqata e gazetarëve, dhe entitete tjera të cilat mund të jenë palë të interesit	23
VII.	Kapitulli i procedurave të brendshme të trajnimit dhe provimit	25

Konform Ligjit Nr. 05/L -045 për Sigurime të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 24.12.2015, Banka Qendrore e Kosovës me datë 31.08.2018 ka miratuar Rregulloren për Licencim e Ndërmjetësuesve në Sigurime. Sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje, Shoqata e Sigurimeve të Kosovës është miratuar si subjekt që të merret me organizimin e edukimit, trajnimit dhe mbajtjes së provimit për licencim dhe trajnimet e vazhdueshme profesionale për ndërmjetësuesit e sigurimeve në territorin e Republikës së Kosovës.

Bazuar nga elaborimi i mësipërm Shoqata e Sigurimeve ka përgatitur këtë manual të trajnimeve i cili do të shërbejë si dokument për të gjitha palët e interesit të përfshira në procedurat e trajnimeve në sigurime, siç janë: ndërmjetësuesit në sigurime (agjentët, kompanitë e agjentëve, brokerët dhe kompanitë e brokerëve, bankat, agjensionet turistike), kompanitë e sigurimit, shoqata e sigurimeve, Banka Qendrore e Kosovës si dhe entitete tjera fizike dhe apo juridike të cilat mund të kenë interes në trajnimet të cilat do të ofrohen nga shoqata e sigurimeve.

Përkufizimet

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – për qëllimin e kësaj rregulloreje, është organ kompetent për:

- licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime;
- revokimin e licencave për ndërmjetësues;
- menaxhimin ose mbikëqyrjen e procedurës së rehabilitimit (administrimit zyrtar) dhe fillimin e procedurave të falimentimit; dhe
- të gjitha aktiviteteteve tjera që kanë të bëjnë me sigurime në Republikën e Kosovës.

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës – është entitet i themeluar nga kompanitë e sigurimit të licencuara për të ushtruar aktivitetin e tyre në sigurime në Republikën e Kosovës. Aktiviteti i Shoqatës është përcaktuar sipas statutit të saj të miratur me ndryshime në vitin 2012.

Ndërmjetësim në sigurime – është veprimtaria e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënies së asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi.

Ndërmjetësues në sigurime – është personi fizik apo juridik i licencuar nga BQK dhe i kontraktuar nga siguruesi, për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime.

Kompani ndërmjetësuese në sigurime – nënkupton kompaninë e agjentëve dhe kompaninë e brokerëve.

Agjenti i sigurimeve – është personi fizik, i licencuar nga BQK dhe i kontraktuar nga siguruesi sipas një kontrate ndërmjetësimi për të zhvilluar aktivitet ndërmjetësimi në sigurime në llogari të siguruesve. Përveç kësaj, agjent i sigurimeve konsiderohet edhe personi fizik që është në marrëdhënie të rregullt pune me kompaninë e agjentëve, bankën ose agjencionin e udhëtimit të licencuar për aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime, për të vepruar në llogari të siguruesve.

Kompani e agjentëve – është person juridik i licencuar nga BQK dhe i kontraktuar nga një ose me shumë sigurues, që të zhvillojë aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime, në llogari të siguruesit.

Broker i sigurimeve – është personi fizik, i licencuar nga BQK që të zhvillojë aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime dhe që vepron në llogari të të siguarve. Brokeri ndërmjetëson në mes të të siguarve dhe një ose më shumë siguruesve me të cilët ka marrëdhënie kontraktuale. Përveç kësaj, broker i sigurimeve konsiderohen edhe personi fizik që është në marrëdhënie të rregullt pune me kompaninë e brokerimit ose bankën e licencuar për aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime.

Kompani e brokerimit - është person juridik i licencuar nga BQK që të zhvillojë aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime dhe që vepron në llogari të të siguruarve. Kompania e brokerimit ndërmjetëson në mes të të siguruarve dhe një ose më shumë siguruesve me të cilët ka marrëdhënie kontraktuale.

***Ky manual i trajnimeve është i ndarë në shtatë
(7) kapituj edhe atë si më poshtë vijon:***

- I. Kapitulli për trajnimet dhe provimin për licencim
- II. Kapitulli për trajnimet e vazhdueshme
- III. Kapitulli për trajnimet profesionale
- IV. Kapitulli për trajnimet për biznese
- V. Kapitulli për trajnimet për Insitucione të edukimit si shkolla, universitete, kolegje dhe si shoqata e gazetarëve, dhe entitete tjera të cilat mund të jenë palë të interesit.
- VI. Kapitulli i procedurave të brendshme të trajnimit dhe provimit
- VII. Kapitulli për pagesat e trajnimeve
- VIII. Kapitulli – Pyetësor dhe analizë për nevojat e trajnimit



Trajnimet dhe provimi për licencim

Në këtë kapitull shtjellohen procedurat e trajnimeve dhe provimit për të gjithë kandidatët të cilët dëshirojnë të licencohen si ndërmjetësues i sigurimeve, për kompanitë e sigurimeve apo edhe si ndërmjetësues të pavarur të sigurimeve.

Në pajtim me rregulloren e BQK për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime, çdo kandidat i cili ka synim licencimin e tij si ndërmjetësues në sigurime, duhet të ndjek trajnimin për licencim, i cili organizohet nga Shoqata e Sigurimeve të Kosovës.

Trajnimet për licencim ndahen në dy grupe:

- Trajnimet për të gjitha veprimtaritë e sigurimeve, respektivisht të gjitha klasat e sigurimit të jetës dhe jo-jetës. Ky trajnim zgjat 5 ditë pune.
- Trajnimet për klasa specifike të sigurimit të jetës dhe/ose jo-jetës (p.sh. klasa nr. 18 – Sigurimi i Asistencës, kupton ofrimin e shërbimit asistues në raste të aksidenteve, prishjeve të mjeteve motorike apo asistencës së transportit të personave që kanë vështirësi gjatë udhëtimeve). Ky trajnim zgjat 2-3 ditë pune.

Pas trajnimit kandidatët i nënshtrohen provimit i cili po ashtu organizohet nga Shoqata e Sigurimeve të Kosovës në bashkëpunim me BQK.

Trajnimi dhe provimi për licencim të kandidatëve për ndërmjetësues të sigurimeve mbahet konform Doracakut të Trajnimeve, i cili është përpiluar nga Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, respektivisht nga komiteti i trajnimeve, dhe i cili është ribotuar në vitin 2016 dhe përbëhet nga gjithësejtë tetë (8) module-kapituj, edhe atë:

1. Hyrje në Sigurime

- a. Historia e Sigurimeve
- b. Menaxhimi i Riskut

2. Principet dhe Biznesi në Sigurime

- a. Principet e Sigurimit
- b. Biznesi në Sigurime

3. Llojet e sigurimeve të përgjithshme (jo-jetë)

- a. Sigurimi nga Autopërgjegjësia
- b. Sigurimi KASKO
- c. Sigurimi nga Zjarri dhe rreziqet shtesë
- d. Sigurimi i objekteve në ndërtim dhe montim (CAR)
- e. Sigurimi aksidenteve personale
- f. Sigurimi shëndetit
- g. Sigurimi shëndetit në udhëtim
- h. Sigurimi i përgjegjësive publike
- i. Sigurimi i garancioneve
- j. Sigurimi i mallrave në tranzit – KARGO

4. Sigurimi i jetës

Ky kapitull u ofron kandidatëve njohuri bazë për sigurimet e jetës duke filluar nga kontrata, llojet e sigurimeve të jetës, marrja në sigurim, rreziqet e mbuluara, kalkulimin e primit, etj.

5. Komunikimi dhe Shitja

Ky kapitull u ofron kandidatëve njohuri bazë për mënyrën e komunikimit profesional të ndërmjetësuesve në sigurime me klientët si dhe mënyrat e suksesshme të shitjes së produkteve të sigurimit.

6. Njohuritë për dëmet

Ky kapitull u ofron kandidatëve njohuri bazë për procedurat e që duhet ndjekur në rast të ndodhjes së dëmit në sigurime duke filluar nga momenti i ndodhjes, njoftimit të siguruesit, paraqitjes së kërkesës për shpërblim deri te realizimi i tij, përkatësisht deri në mbylljen e dosjes së një dëmi.

7. Risigurimet

Ky kapitull u ofron kandidatëve njohuri bazë për risigurimet si çka janë risigurimet, llojet e kontratave të risigurimit, etj.

8. Legjislacioni vendor dhe mbrojtja e konsumatorit

Ky kapitull u ofron kandidatëve njohuri bazë për legjislacionin e sigurimeve në Republikën e Kosovës, duke filluar nga Ligji për Sigurime, Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, rregulloret e BQK-së për sigurimet dhe parimet e përgjithshme në sigurime.

Për mënyrën e detajuar të organizimit dhe mbarëvajtjes së trajnimeve për licencim dhe provimit për licencim, referojuni kapitullit të VI të këtij manuali, i cili i shtjellon procedurat e brendshme të trajnimit dhe provimit për licencim të organizuara nga Shoqata e Sigurimeve në bashkëpunim me BQK.



Trajnimet e vazhdueshme

Sipas nenit 14, pika 5 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, të gjithë ndërmjetësuesit në sigurime janë të obliguar të ndjekin trajnimin – edukimin e vazhdueshëm profesional edhe atë:

- së paku 10 orë trajnim profesional brenda një viti kalendarik, për të gjithë agjentët të cilët janë të licencuar për të ushtruar aktivitetin e tyre si agjentë të sigurimeve, dhe
- së paku 20 orë trajnim profesional brenda një viti kalendarik, për të gjithë brokerët të cilët janë të licencuar për të ushtruar aktivitetin e tyre si broker i sigurimeve.

Tema e trajnimeve të vazhdueshme profesionale për çdo vit përzgjidhet në bashkëpunim me BQK dhe konform nevojave të tregut të sigurimeve respektivisht ndërmjetësuesve të sigurimeve.

Orarin dhe vendin e trajnimeve të vazhdueshme profesionale e përcakton Shoqata e Sigurimeve me njoftim paraprak të BQK-së. Ky orar përpilohet duke ju përshtatur kohës së ndërmjetësuesve në sigurime.

Varësisht nga tema e përzgjedhur për trajnimet vazhdueshme profesionale, Shoqata e Sigurimeve mund të angazhojë ligjërues nga industria e sigurimeve apo jasht vendit, të cilët janë profesionistë në fushën e sigurimeve, respektivisht në temën e cila është përzgjedhur nga Shoqata për këto trajnime.

Pas përfundimit të trajnimeve të vazhdueshme profesionale, Shoqata e Sigurimeve lëshon çertifikatën për të gjithë ndërmjetësuesit e sigurimeve, si dëshmi se kandidatët e kanë kryer me sukses trajnimin e vazhdueshëm profesional për vitin përkatës.



Trajnimet profesionale

Ky lloj i trajnimit i përket një niveli më të lartë të trajnimeve dhe ju dedikohet kryesisht ekspertëve të fushave përkatëse të cilët janë të punësuar në kompanitë e sigurimit dhe ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të të punësuarve në kompanitë e sigurimit.

Temat e trajnimit përcaktohen nga Shoqata e Sigurimeve në bashkëpunim me departamentet përkatëse të kompanive të sigurimit dhe nevojave të tyre si: departamenti i marrjes në sigurim, i dëmeve, i financave, ligjor, i marketingut, auditimit të brendshëm, etj.

Shoqata për këto trajnime në bashkëpunim me departamentet përkatëse të kompanive të sigurimit, ju jep prioritet temave duke ju përshtatur nevojave të tregut të sigurimeve.

Trajnimet profesionale zgjasin 2-3, në raste të caktuara edhe më tepër, kjo gjithnjë në varësi të temave të përzgjedhura. Brenda vitit shoqata e sigurimeve organizon 2-4 trajnime profesionale.

Shoqata e Sigurimeve organizon trajnimet profesionale me entitete profesionale të fushave përkatëse, duke e përshtatur me temën e përzgjedhur për trajnim, me organizata ndërkombëtare me renome në fushën e trajnimeve për lëmin e sigurimeve, por edhe me entitete vendore të cilat mund të përmbushin standardet e kërkuara për trajnime profesionale në lëmin e sigurimeve.

Në fund të çdo trajnimi profesional, Shoqata e Sigurimeve në bashkëpunim me organizatën e përzgjedhur për të ofruar trajnimin profesional lëshon certifikatë pë të gjithë pjesëmarrësit të cilët e kanë ndjekur trajnimin.



Trajnimet për biznese

Këto lloj trajnime do të organizohen dhe mbahen nga Shoqata e Sigurimeve, për bizneset në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Qëllimi kryesor i këtyre trajnimeve do të jetë njoftimi i bizneseve kosovare me fushën e sigurimeve, rëndësinë e sigurimeve në ekonominë e një vendi, si dhe do të ketë një fokusim të veçantë në vetëdijësimin e bizneseve për sigurimet.

Këto trajnime do të organizohen për të gjitha bizneset dhe apo ndërmarrjet qofshin ato të vogla, të mesme apo të mëdha, varësisht prej marrëveshjeve të arritura me bizneset për trajnime.

Orari i këtyre trajnimeve përpilohet nga Shoqata e Sigurimeve në dakordim me bizneset.

Në këto trajnime, përfaqësuesit e bizneseve do të kenë mundësinë e marrjes së informacionit mbi produktet e sigurimit që ofrohen nga kompanitë e sigurimit, për të cilat ata mund të kenë nevojë e që nuk kanë pasur njohuri për ofrimin e produkteve të tilla të sigurimit.



Këto trajnime qëllim kryesor e kanë vetëdijësimin e nxënësve, studentëve dhe gazetarëve, për:

- ■ rëndësin e sigurimeve në ekonomi
- ■ mënyrën e funksionimit të sigurimeve
- ■ tregun e sigurimeve në Kosovë dhe atë ndërkombëtar
- ■ shitësit dhe blerësit në sigurime
- ■ kompanit e sigurimeve
- ■ ndërmjetësit e sigurimeve
- ■ klasat e sigurimeve etj.

Orari i këtyre trajnimeve përpilohet nga Shoqata e Sigurimeve në dakordim me entitetet e cekura më lartë dhe në bazë të memorandumeve të cilat nënshkruhen mes Shoqatës së sigurimeve dhe entiteteve të mësipërme.

Trajnimet për insitucione të edukimit si shkolla, universitete, kolegje, shoqata e gazetarëve dhe entitete tjera të cilat mund të jenë palë të interesit

Një formë tjetër e trajnimit apo edukimit të publikut për rëndësinë e sigurimeve do të jenë edhe trajnimet të cilat shoqata do ti organizojë për institucionet arsimore siç janë shkollat, universitetet dhe shoqata të ndryshme si p.sh. për nxënësit dhe studentet të cilët në kurrikulën e tyre e kanë në mënyrë direkte apo indirekte edhe lëndën e sigurimeve si dhe shoqatat e gazetarëve, me theks të veçantë gazetarët e ekonomisë.

Këto trajnime qëllim kryesor e kanë vetëdijësimin e nxënësve, studentëve dhe gazetarëve, për:

- rëndësinë e sigurimeve në ekonomi,
- mënyrën e funksionimit të sigurimeve,
- tregun e sigurimeve në Kosovë dhe atë ndërkombëtar,
- shitësit dhe blerësit në sigurime,
- kompanit e sigurimeve,
- ndërmjetësit e sigurimeve,
- klasat e sigurimeve etj.

Orari i këtyre trajnimeve përpilohet nga Shoqata e Sigurimeve në dakordim me entitetet e cekura më lartë dhe në bazë të memorandumeve të cilat nënshkruhen mes Shoqatës së sigurimeve dhe entiteteve të mësipërme.

Procedurat e brendshme të trajnimit dhe provimit

Qëllimi i procedurave të brendshme për trajnimet dhe testimet në shoqatën e Sigurimeve të Kosovës, është të përcaktojë qartë kushtet, kriteret dhe afatet të cilat do të përdoren respektivisht respektohen për trajnimet dhe testimet e kandidatëve për ndërmjetësues të sigurimeve, të të gjitha kategorive dhe të të gjitha klasave të sigurimeve. Sipas nenit 10 të rregullores së BQK për Licencimin e Ndërmjetësuesve, Shoqata e Sigurimeve është autorizuar të organizojë trajnimet për licencim së bashku me provimin/testimin, si dhe trajnimet e vazhdueshme profesionale, në pajtim me rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në sigurime.

Neni 1

Trajnimet për Licencim

- 1.1. Të gjithë kandidatët të cilët dëshirojnë të aplikojnë për licencim si ndërmjetësues të sigurimeve pranë BQK, duhet ti nështrohen trajnimit paraparak pranë Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës.
- 1.2. Organizimin dhe mbarëvajtjen e trajnimeve për licencim, e merr përsipër Shoqata e Sigurimeve
- 1.3. Kërkesa për vijimin e trajnimit pranë Shoqatës së Sigurimeve që do të shërbejnë për licencim nga BQK paraqitet pranë Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, nga persona fizik dhe juridik siç janë kompanitë e sigurimeve, kompanitë brokere, brokerët, kompanitë e agjentëve, banka ose agjensioni i udhëtimit.
- 1.4. Trajnimet organizohen në çdo kohë kur ka kërkesa për vijimin të njejtave. Në parim, trajnimet mund të organizohen kur numri i kandidatëve varion minimalisht nga 4 – 10 të tillë. Nëse konsiderohet që numri i tillë nuk përmbushet brenda një afati të shkurtë kohor, trajnimi do të mbahet me kandidatët të cilët kanë paraqitur kërkesën për trajnim.

- 1.5. Trajnimet për licencim ndahen në trajnime 2-3 ditore dhe 5 ditore.
- 1.6. Trajnimi për të gjitha klasat e sigurimeve të njohura sipas Ligjit për Sigurime (ku nga sigurimet jo-jetë janë 18 klasa të sigurimit dhe nga sigurimet e jetës janë 6 klasa të sigurimit) përfshin edhe sigurimin e jetës dhe zgjatë 5 ditë pune.
- 1.7. Trajnimi për një klasë specifike (p.sh. klasa nr. 18 - Sigurimi i Asistencës (shërbimit asistues në raste të aksidenteve, prishjeve të mjeteve motorike apo asistencës së transportit të personave që kanë vështirësi gjatë udhëtimeve) zgjatë 2-3 ditë.
- 1.8. Trajnimi si tërësi zhvillohet nga Doracaku i trajnimeve i botuar nga Shoqata e Sigurimeve, por kjo nuk e përjashton mundësinë e përdorimit të ndonjë materiali shtesë, nëse për një gjë të tillë paraprakisht janë dakorduar me shkrim BQK dhe Shoqata.
- 1.9. Personeli i Qendrës së Trajnimeve pranë Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës mbanë ligjeratat për trajnimin e organizuara. Në varësi të temave të caktuara për trajtim, Shoqata e Sigurimeve mund të kontrakttojë ligjerues nga industria e sigurimeve apo ekspertë të fushës nga vendet jashtë Kosovës për të ligjeruar në kuadër të trajnimeve të organizuara.
- 1.10. Pas trajnimit 2-3 ditor dhe/ose 5 ditor, kandidatëve ju lejohet që një periudhë prej 5 ditëve të punës për përgatitje për provim.
- 1.11. Data për provim/testimit propozohet nga Shoqata dhe miratohet nga BQK.
- 1.12. Provimi mbikëqyret nga komisioni i përbashkët i formuar nga përfaqësues të BQK dhe Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës. Testet e provimit kontrollohen nga komisioni i përbashkët mes BQK dhe Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës.
- 1.13. Rezultatet e testit publikohen më së largu pas 5 ditë pune pas datës së mbajtjes së provimit.
- 1.14. Provimi mbahet në zyrat e Shoqatës në kohën dhe datën e paracaktuar, sipas dakordimit paraprak me BQK.

- 1.15. Të gjitha pyetjet e provimit nxirren nga Doracaku i trajnimeve dhe/apo materiali shtesë nëse për një gjë të tillë paraprakisht janë dakorduar me shkrim BQK dhe Shoqata e Sigurimeve. Pyetjet në testim gjenerohen përmes programit kompjuterit me konfigurim automatik, në përzgjedhje të rastësishme të pyetjeve.
- 1.16. Provimi bëhet me shkrim dhe zgjat 60 minuta për trajnimet 5 ditore, respektivisht 45 minuta për trajnimet 2-3 ditore.
- 1.17. Kandidatët në provim identifikohen vetëm përmes numrit personal të letërnjoftimit dhe në testim nuk shkruhet emri dhe mbiemri.
- 1.18. Kandidatët të cilët kanë munguar 3 ditë nga trajnimi 5 ditor nuk kanë të drejtë ti nënshtrohen provimit. Të njëjtit, duhet të paraqesin kërkesë të re për vijimin e trajnimit, të paguajnë tarifën përketëse rishtaz dhe të ndjekin procedurat e mëtutjeshme të përcaktuara me këtë manual.
- 1.19. Kandidatët të cilët kanë munguar 1 ditë nga trajnimi 2-3 ditor nuk mund ti nënshtrohen provimit. Të njëjtit, duhet të paraqesin kërkesë të re për vijimin e trajnimit, të paguajnë tarifën përketëse rishtaz dhe të ndjekin procedurat e mëtutjeshme të përcaktuara me këtë manual.
- 1.20. Numri i pyetjeve për testim për trajnimet 5 ditore varion nga 30 deri 35, ndërsa numri i pyetjeve për trajnimet 2-3 ditore varion nga 20-25 sosh.
- 1.21. Numri i pyetjeve për testim për kandidatët për broker individual apo kompani brokerimi sillet nga 35 – 45.
- 1.22. Kandidatët të cilët i përgjigjen saktë 60% të pyetjeve të provimit, llogaritet se e kanë kaluar provimin me sukses. Niveli i kalueshmërisë së testimit mund të ndryshohet nëse vlerësohet si e nevojshme.
- 1.23. Pyetjet e testit nxirren në mënyrë automatike përmes softverit të menaxhuar nga Shoqata. Pyetjet për secilin test përcaktohen në mënyrë rastësore.
- 1.24. Kandidatët të cilët nuk e kanë kryer me sukses provimin herën e parë, kanë të drejtë ti nënshtrohen provimit edhe dy herë të

tjera përmes ri-testimit. Çdo kandidat ka të drejtë në shqimin e testit dhe ri-vlerësimit të të njëjtit, brenda afatit prej 2 ditëve nga dita e njoftimit. Rivlerësimi i testit bëhet nga komisioni përkatës i formuar në harmoni me këtë manual.

- 1.25. Kandidatët të cilët do të ri-testohen, këtë mund ta bëjnë pasi të kenë kaluar 30 ditë nga data e testimit të parë, respektivisht të dytë
- 1.26. Kandidatët të cilët nuk e kalojnë me sukses provimin gjatë 3 mundësive të dhëna, nuk kanë të drejtë të paraqitjes në testim në periudhë gjashtë mujore nga data kur nuk kanë kaluar me sukses provimin për herë të tretë.



Neni 2

Trajnimet e vazhdueshme

- 2.1. Sipas nenit 10, pika 5 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, të gjithë ndërmjetësuesit e sigurimeve e kanë obligim që të ndjekin edukimin/trajnimin e vazhdueshëm brenda një viti kalendarik.
- 2.2. Të gjithë agjentët e licencuar duhet të ndjekin trajnimin e vazhdueshëm, çdo vit me minimum 10 orë brenda vitit.
- 2.3. Të gjithë brokerët e licencuar duhet të ndjekin trajnimin e vazhdueshëm çdo vit me minimum 20 orë brenda vitit.
- 2.4. Temat e trajnimit të vazhdueshëm i cakton Shoqata e Sigurimeve në bashkëpunim me anëtarët e saj dhe BQK.
- 2.5. Për trajnimet e vazhdueshme të gjithë ndërmjetësuesit pajisen me certifikatë pjesëmarrje të cilën e lëshon Shoqata e sigurimeve.
- 2.6. Personeli i Qendrës së Trajnimeve pranë Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës mbanë ligjeratat për trajnimin e vazhdueshme. Në varësi të temave të caktuara, Shoqata e Sigurimeve mund të kontrakttojë ligjerues nga industria e sigurimeve apo ekspertë të fushës nga vendet jashtë Kosovës për të ligjeruar në kuadër të trajnimeve të organizuara.
- 2.7. BQK ka të drejtë që gjatë organizimit të trajnimeve të vazhdueshme të dërgojë një vëzhgues për pjesëmarrje.
- 2.8. Në trajnimet e vazhdueshme ndërmjetësuesit nuk i nënshtrohen testimi/provimit.

Pagesat e trajnimeve

Siguruesit, ndërmjetësuesit apo kandidatët përkatës të cilët kanë paraqitur kërkesë për vijimin e trajnimit për licencim apo trajnimet e vazhdueshme, duhet të përmbushin detyrimet përkatëse ndaj Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, në harmoni me tarifat e miratuara nga Kuvendi i Shoqatës.

Për trajnimet për licencim, pagesa përkatëse nga kompania ose kandidati duhet të paguhet gjatë javës që vijohet trajnimi, e më së largu para datës së mbajtjes së testimit. Në rast se pagesa nuk është kryer, kandidati përkatës nuk do ti lejohet testimi, deri në përmbushjen e të njejtës.

Për trajnimet e vazhdueshme, në rast të mospagesës së tarifës përkatëse për trajnim Shoqata gëzon të drejtën e shtyerjes së trajnimit deri në pagesën e detyrimit nga siguruesi, ndërmjetësuesi apo kandidatët që do ti nënshtrohen trajnimeve.

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës nuk do të bartë asnjë pasojë apo përgjegjësi, për shkak të mosrealizimit të trajnimeve/testimeve që janë si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve ndaj Shoqatës.

Protection

INSURANCE

Risk
management

Business

Home

Kapitulli VII

Pyetësor dhe analizë për nevojat e trajnimit

Pyetësi

Faza e nominimit:

- **Si e nominon kompania juaj një person për të marrë pjesë në trajnim?**

Pse e nominoni personin e caktuar X nga stafi juaj për të marrë pjesë në trajnim?

Si ja komunikoni atij lajmin se duhet të marrë pjesë në trajnim?

A e kuptoni ju dhe stafi juaj në të njëjtën mënyrë implikimet që do të ketë në këtë trajnim?

Si e pranon (ndjehet) stafi i përzgjedhur nga ju, lidhur me pjesëmarrjen në trajnim?

Si ndikon te pjesa tjetër e stafit nominimi i një ose disa personave për të ndjekur trajnimin?

A mund të ndikojë në punën tuaj mungesa e stafit të nominuar për trajnim?

- Për çfarë aftësime/trajnime ka nevojë stafi juaj në mënyrë që të performojë më mirë në punën e tij?
- Çfarë dëshironi që të përmirësoni në punën e stafit tuaj?
- Çfarë janë aspiratat e kompanisë suaj për të ardhmen e stafit tuaj?
- Nëse jeni të kenaqur me performancën e stafit tuaj, mundohuni ti gjeni pikat në të cilat ju mendoni se stafi duhet të performojë më mirë.

- Qfarë mendoni se duhet të përmiresohet në punën e departamenteve të kompanisë suaj?
- Cilat janë nevojat imediate për trajnim, për stafin e kompanisë suaj, duke marrë inpute nga secili departament?

Analiza për nevojat e trajnimit

1. A keni formë të vlerësimit të punës për stafin tuaj? Nëse po, a i mbledhni shënimet e rëndësishme nga kjo formë e vlerësimit?
2. A keni zyrtar të trajnimit?
3. A takohet zyrtari i trajnimit me stafin si tërësi?
4. Sa shpesh takohet zyrtari i trajnimit me shefat e departamenteve për të analizuar punën, performancën dhe për të diskutuar për nevojat e trajnimit?
5. Kush i vlerëson dhe miraton nevojat për trajnim në kompaninë tuaj?
6. Kush vendos për aranzhimin e trajnimeve?

Shtojcë e këtij manuali do të jenë tarifat e miratuara nga Bordi i Drejtorëve, të pagueshme nga siguruesit dhe/apo ndërmjetësuesit në sigurime për ndjekjen e trajnimit për licencim dhe ato të vazhdueshme për ndërmjetësuesit në sigurime.

Ky manual është përgatitur nga Qendra e Trajnimit pranë Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës

Sami Mazreku

Adem Selmani Dip.CII,

Drejtor Ekzekutiv

Shef i Qendrës së Trajnimeve



Adresa: Sheshi Nënë Tereza nr.34/3
10.000 Prishtinë • Republika e Kosovës

www.shs-ks.com